Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

23. Njoftimi i Fituesit

1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) garanci bankare
- b) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore.
2. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 te LPP dhe nenin 75 te VKM 285/2021.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës

Shtojca 1/1. Formulari i Ofertës

Shtojca 2. Listat e Çmimeve të artikujve

Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 6. Formulari i Sasisë dhe Grafikut i lëvrimit

Shtojca 7. Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 8. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 9 : Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 10 Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraprak)

Shtojca 11- Formulari i Njoftimit të Fituesit (Në përfundim të afateve të ankimit)

Shtojca 12 : Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Paraprak)

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Në përfundim të afateve të ankimit)

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

f) Çmimi total i Ofertës sonë, me TVSH, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 1/1.

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët*]

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlere absolute është si më poshtë

1	2	3
Nr.	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njësi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					

Datë _____	
-------------------	--

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Ne baze te nenit 4, pika 38/b të LPP :“Specifikime teknike” janë: b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuar dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë dhe nenit 36, pika 3/b të LPP: Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar: kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”: Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, specifikimet teknike si më poshtë plotësojnë kushtin për materiale cilësore:

Specifikime Teknike për Blerje oksigjen mjekësor (oksigen lëng dhe gaz) për SUT”, për një periudhë 24 muajore e ndare në dy- lote

- **LOTI 1 – “Furnizim me Oksigjen të lëngshëm për përdorim mjekësor për një periudhë 24 muajore”**
- **LOTI 1 – “Furnizim me Oksigjen Gaz për përdorim mjekësor për një periudhë 24 muajore”**

LOTI 1 – Furnizim me Oksigjen të lëngshëm për përdorim mjekësor

Përbërësit në përqindje:

Oksigjen	O ₂	99,5 %
----------	----------------	--------

Sipas Farmakopese Nderkombetare, për prodhimin e oksigjenit nga procesi i lëngzimit të ajrit, përcakton se kërkesa për oksigjenin për përdorim mjekësor duhet të jetë minimumi 99.5% v/v oksigjen.

Shenim: v/v % (vëllimi i lëndës së tretur / vëllimi i tretësirës) *100%

Afati i skadencës do të jetë: *Data e skadencës në ditën e lëvrimit të mallit duhet të jetë jo më pak se 1/2 e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës.*

Kërkesat për furnizimin **OKSIGJEN LENG** janë si më poshtë:

II. Kushtet e furnizimit.

Automjetet

Furnizimi të bëhet me autobotet e furnizuesit të pajisur me :

1. Leje për Transport gazra mjekësore nën presion, të lëshuar nga Inspektoriati Shteteror Teknik dhe Industrial.
2. Leje për Transport gazra mjekësore nën presion të lëshuar nga MNZSH.
3. Certifikatë miratimi ADR të lëshuar nga DPSHTRR.

Tankerat e Oksigjenit

Tankerat duhet të certifikohen nga **Inspektorati Shteteror Teknik dhe Industrial** (Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve nën Presion) dhe duhet të nënshtrohen inspektimeve sipas afateve të percaktuara ligjore.

Furnizimi dhe depozitimi i Oksigjenit të lenget do të bëhet në përputhje me kushtet teknike dhe të sigurisë, në tankerat në pikat e percaktuara nga SUT, të cilat jepen si më poshtë:

Gaz për përdorim mjekësor, i lengshëm:

Nr	Institucioni	Nr i tankereve	Kapaciteti në litra	Pronesia	Vend ndodhja
	SUT	1	10.000	Pronesi e operatorit ekonomik	Në ambientet e spitalit

Operatori Ekonomik duhet të furnizojë dhe montojë pranë AK, tankerat të cilat do të jenë në përdorim të SUT deri në ndërrimin e tankerit nga operatori tjetër pas përfundimit të marreveshjes kuader. OE i kontraktuar duhet të ketë gjendje një tanker rezerve me kapacitet 10 mijë litra.

OE ka detyrimin për certifikimin e Tankerave në Inspektoriatin Shteteror Teknik dhe Industrial (Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve nën Presion), rregjistrimin dhe ndjekjen e kryerjes së inspektimeve sipas afateve të percaktuara ligjore.

Operatori Ekonomik është përgjegjës për montimin, kontrollin dhe mirëmbajtjen në përputhje me kushtet teknike dhe legjislativën në fuqi. Këto tankera, në varesi të nevojave të AK, do të shtohen ose pakesohen si numër.

Aparatet matëse të depoziatave/tankerave të jenë të kolauduara nga institucionet kompetente. Me lidhjen e MK, të vihet dokumentacioni i kolaudimit të aparatave matëse, grupit të punës të marrjes në dorëzim të mallit nga OE.

III. Kërkesa të veçanta

1. Brenda 30 ditëve nga lidhja e Marreveshjes Kuader, Operatori Ekonomik fitues, në marreveshje me SUT, duhet të realizojë furnizimin dhe montimin e tankerave të tij (zëvendësimin e tankerave të kontraktorit të vjetër,) pranë AK. Pas instalimit të tankerave, OE fitues duhet të kryejë rregjistrimin dhe certifikimin e tyre pranë **Inspektoratit Shteteror Teknik dhe Industrial**.
2. Për periudhën e zgjatjes së punimeve, kontraktori duhet të marrë masat për të mos ndërprerë furnizimin me oksigjen të shërbimeve spitalore, që përdorin vetëm oksigjen të lengshëm duke furnizuar më parë rampat e oksigjenit të gaztë me bombola 30-40 litershe me presion deri në 125 bar, sipas nevojave të spitaleve me një sasi konsumi ditor si më poshtë:

- **Nevojat për SUT**

- Rampa e SUT, parashikon nevojat per 50 cope bombola 30-40 litërshe, presion deri ne 125 bar,
3. Operatori ekonomik duhet te siguroje, ne rast avarie te tankerit te oksigjenit lëng, furnizimin me tanker rezerve ose me bombola oksigjeni mjeksor gaz, në rampat e oksigjenit të gaztë, për te siguruar gadishmerine e furnizimit me oksigjen te shërbimeve spitalore 24/24 sipas nevojave te AK. Sasia e oksigjenit mjeksor të gaztë të konsumuar gjatë kesaj periudhe do të konvertohet në oksigjen të lëngët sipas normativave teknike, ne rast nevojash dhe kur duhet.

Shenim: Oksigjeni i bombolave qe do te perdoren sipas pikes 2 duhet te jete i regjistruar ne AKBPM per tregtim ne Republiken e Shqiperise.

➤ II. Kushtet e furnizimit - OKSIGJEN GAZ

LOTI 2 - Furnizim me Oksigjen Gaz për përdorim mjekësor

Bombolat e oksigjenit duhet te shoqerohen me vertetimin e kryerjes se kontrolleve periodike te **Inspektorati Shteteror Teknik dhe Industrial** (Drejtoria e Inspektimit te Pajisjeve nen Presion) ose/ **organet kompetente për regjistrimin, kontrollin e kushteve teknike dhe te sigurisë, per enët nën presion tankera/serbatore/cisterna**, sipas percaktimeve ligjore.

Transporti i bombolave te oksigjenit mjekësor, i kompresuar, duhet te bëhet me automjete të pajisur me:

1. Leje për Transport gazra mjekësore nën presion, të lëshuar nga Inspektoriati Shteteror Teknik dhe Industrial.
2. Leje për Transport gazra mjekësore nën presion të lëshuar nga MNZSH.
3. Certifikatë miratimi ADR të lëshuar nga DPSHTRR.

Furnizimi do behet me bombola 30 - 40 ose 50 litra me presion deri ne 125 bar.

Operatori duhet te garantoje mbajtjen e nje sasio rezerve brenda vendit, 150 bombola, minimalisht per nevojat 15 ditore, ne varesi te vellimit te nje bombule.

Shenim: Oksigjeni i bombolave qe do te perdoren duhet te jete i regjistruar ne AKBPM per tregtim ne Republiken e Shqiperise.

➤ **Kërkesa te veçanta (te njëjta për te dyja Lotet)**

Furnizimi do te bëhet sipas nevojave dhe kerkesave te SUT (te pakten nje here ne muaj). Njoftimet lidhur me kerkesat per furnizim, duhet te behen ne adresen e emailit te OE te kontraktuar ose ne numrin e telefonit qe do te percaktohet si pike kontakti. Njoftimi duhet bere 2 dite pune para, pa perfshire ditet e pushimit zyrtar por me kushtin qe ne rast emergjence OE duhet te furnizojë AK brenda 24 oreve nga njoftimi. Sasia e parashikuar per nje periudhe 24 mujore dhe origjina e mallit duhet te plotesohet sipas tabelës se meposhtme:

Nr Lot	Emërtimi	Sistemi	Formë/ doza	Njësia	Sasia per nje periudhe 24 mujore	Cmi mi/nj ësi	Vlera Lekë pa TVSH	Kompania Prodhuese/ MAH	Orgjina (Vendi Prodhi mit)
1	Oxygen	Anestezi Reanimacion	Gaz per perdorim mjeksor, i	Litra	180,000				

			lengshem x 100%						
2	Oxygen	Anastezi Reanimacion	Gaz per perdorim mjeksor, i kompresuar x 100%	Litra	6,000				

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr Lot	Emërtimi	Sistemi	Formë/ doza	Njësia	Sasia per nje periudhe 24 muajore
1	Oxygen	Anestezi Reanimacion	Gaz per perdorim mjeksor, i lengshem x 100%	Litra	180,000
2	Oxygen	Anastezi Reanimacion	Gaz per perdorim mjeksor, i kompresuar x 100%	Litra	6,000

Afatet e lëvrimit: sipas kërkesave të AK brenda afatit njezetë e katër muajor të Marrveshjes kuadër te nënshkruar me OE te suksesshëm.

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

Kriteret e përgjithshme janë të njëjta për të dy lotet

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2.1. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

PËR LOTIN 1 – Furnizim me Oksigjen të lëngshëm për përdorim mjekësor

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: -

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit financiare (2021 ,2022, 2023) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më të vogël se 39% e vlerës së fondit limit.

Shënim: Për efekt të përlllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, vlera mesatare do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar sipas sasive të pritshme të lotit/lotëve për të cilët OE ofertohej.

Kur konkurrohet për më shumë se 1 lot, vlera mesatare do të aplikohet mbi shumën totale të vlerës së pritshme të kontratave për lotet që konkurrohet.

Nëse operatorët ekonomikë, për lotin/lotet që konkurrojnë, arrijnë vlerën e xhiros jo më e vogël se 39% të kërkuar në këto DT, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur.

2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale:

2.3.1 Dëshmi nga operatori ekonomik për furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më e vogël se 20% e vlerës së fondit limit dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Shënim: Vlera furnizimeve të mëparshme të ngjashme për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë duhet të jetë jo më e vogël se 20% e fondit limit/vlera e pritshme e kontratave të lotit, apo shumës së loteve për të cilat OE do të ofertohej. Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme për tregtim me shumice të barnave të lëshuar nga QKL ose QKB.

2.3.3. Operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë origjinën e mallit dhe kompaninë prodhuese/MAH, kjo të plotësohet në *Shtojçën 2. Listat e Çmimeve të artikujve* të DST.

2.3.4. OE duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

- dokumenti i cili konfirmon se bari i ofertuar (oksigjeni gaz* dhe i lëngshëm*), është i pajisur me autorizim për tregtim në Republikën e Shqipërisë, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore
/ose/
- autorizimi për tregtim i barit (oksigjeni gaz* dhe i lëngshëm*), lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, brenda afatit të tij të vlefshmërisë.

****Shënim:*** PËR LOTIN 1 – Furnizim me Oksigjen të lëngshëm për përdorim mjekësor - OE duhet të ketë autorizimin për tregtim për oksigjenin gaz dhe autorizimin për tregtim për oksigjenin të lëngshëm sipas pikes “III. Kërkesa të veçanta” të specifikimeve teknike për Lotin 1. Për këtë arsye OE duhet të disponojë të autorizim për tregtim të barit oksigjen gaz dhe autorizim për tregtim të barit oksigjen të lëngshëm.

2.3.5. Kërkohet Autorizim (i vlefshëm për periudhën e parashikuar të Marrëveshjes kuadër), lëshuar nga MAH (mbajtësi i autorizimit të tregtimit), nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë barnat e tij në vendin tonë.

2.3.6. Certifikate ISO 9001-2015 ose ekuivalent, të vlefshme, për distribucionin e gazrave mjekësore, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

2.3.7. Certifikate OHSAS 18001:2007, të vlefshme, për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë / ose / ISO 45001-2018 (certifikatë ekuivalente të azhornuar), ose ekuivalent. Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar

nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

2.3.8. Certifikatë ISO 14001:2015 –Sistemi i menaxhimit mjedisor ose ekuivalent, të vlefshme, për distribucionin e gazrave mjekësore, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

2.3.9 OE duhet të disponojë dokumentacion për Automjetet si më poshtë:

Furnizimi të bëhet me autobotet e furnizuesit të pajisur me:

1. Leje për Transport gazra mjekësore nën presion, të lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial.
2. Leje për Transport gazra mjekësore nën presion të lëshuar nga MNZSH.
3. Certifikatë miratimi ADR të lëshuar nga DPSHTRR.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e vetëdeklarimit (sipas shtojcës 8)

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të provojë se nëse shpallet fitues, se është në gjendje të sigurojë një tanker oksigjeni me kapacitet jo më pak se 10,000 (dhjetë mijë) litra, për ta instaluar brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës. OE duhet të realizojë furnizimin dhe montimin e tankerit të tij pranë AK. OE duhet të disponojë minimumi 2 tankera (me kapacitet minimumi 10,000 litra) sipas nevojave aktuale të Spitalit Universitar të Traumës

Shënim. SUT ka të instaluar një Tanker me kapacitet dhjetë mijë litra në ambientet e tij (në pronësi të OE të kontraktuar) dhe Operatori ekonomik duhet të sigurojë, se në rast avarie të tankerit të oksigjenit lëng, do të furnizojë Ak me një tanker tjetër rezerve (si dhe me bombola oksigjeni mjekësor gaz për periudhën e zëvendësimit të tankerave), për të siguruar gatishmërinë e furnizimit me oksigjen të shërbimeve spitalore 24/24 sipas nevojave të AK.

- Ne rastin kur OE i ka në pronësi, duhet të paraqesë një dëshmi për pronësinë mbi këto tankera (fature blerje ose dokument doganor për importimin e tankerave të oksigjenit ose cdo lloj dokumenti tjetër ligjor i cili dëshmon disponimin në pronësi të këtyre tankerave) dhe Vërtetimin e lëshuar të vlefshëm nga organet kompetente për regjistrimin, kontrollin e kushteve teknike dhe të sigurisë, për enët nën presion tankera/serbatore/cisterna, konform legjislacionit në fuqi, ku të jënë përcaktuar numri dhe kapaciteti i tyre, data e kontrollit, organi inspektues dhe plotësimi i standardeve, kushteve teknike dhe të sigurisë.
- Ne rast se tankerat e oksigjenit do të merren me qira, duhet të paraqitet kontrata ose marrëveshja paraprake e qirasë, shoqëruar me dokumentacionin që vërteton pronësinë e pronarit të tankerave të oksigjenit të vlefshëm nga organet kompetente për regjistrimin, kontrollin e kushteve teknike dhe të sigurisë, për enët nën presion tankera/serbatore/cisterna, konform legjislacionit në fuqi, ku të jënë përcaktuar numri dhe kapaciteti i tyre, data e kontrollit, organi inspektues dhe plotësimi i standardeve, kushteve teknike dhe të sigurisë.

2.3.11 Operatori ekonomik duhet të vetedeklarojë se gjatë gjithë kohës së afatit të MK, do të ketë gjendje brenda territorit të Shqipërisë një sasi rezerve oksigjeni mjekësor të lëngshëm, jo më pak se 20.000 litra, për mbulimin e nevojave emergjente. Duke qene se oksigjeni i lëngshëm është jetik, dhe shërben si terapi për pacientet, dhe për të garantuar vazhdimësinë me furnizim në rast të ndonjë situatë të jashtëzakonshme (pandemi, problem në fabrikën e prodhimit, etj.), duhet që subjekti duhet të ketë sasi rezerve për furnizim.

Shënim: KVO rezervon të drejtën e verifikimit të të dhënave të paraqitura nga ofertuesit.

Shënime:

Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, **i ndryshuar**, ku parashikohet : *“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”*, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: **“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”**.

- Disponimi i kapaciteteve sipas **pikave 8, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit Oxygen i Gaztë dhe Oxygen i Lëngshëm**, do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit (shtojca 8) gjatë fazës së ofertimit.
- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, do t'i kërkojë ofertuesit fitues nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 8 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit përmbushes për këto pika do të jetë kusht skualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor mund të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht skualifikimi.
- Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

CERTIFIKATAT E CILËSISË

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatat e kërkuara të cilësisë sipas zërave të që merr përsipër të realizojë në akt marrëveshje.

Të gjithë dokumentet duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

2.1. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

PËR LOTIN 2 - Furnizim me Oksigjen Gaz për përdorim mjekësor

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: -

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjate 3 (tre) viteve të fundit financiare (2021 ,2022, 2023) ku vlera e tyre te jete jo me e vogël se 40% e vlerës së fondit limit.

Shënim:*Për efekt të përlllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, vlera mesatare do te aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar sipas sasive të pritshme të lotit/lotëve për të cilët OE ofertohe.

Kur konkurrohet për më shumë se 1 lot, vlera mesatare do te aplikohet mbi shumën totale të vlerës së pritshme të kontratave për lotet që konkurrohet.

Nëse operatorët ekonomikë, për lotin/lotet që konkurrojnë, arrijnë vlerën e xhiros jo me e vogël se 40% të kërkuar në këto DT, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur.

2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale:

2.3.1 Dëshmi nga operatori ekonomik për furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më e vogël se 20% e vlerës së fondit limit dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Shënim: Vlera furnizimeve të mëparshme të ngjashme për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë duhet të jetë jo më e vogël se 20% e fondit limit/vlera e pritshme e kontratave të lotit, apo shumës së lotëve për te cilat OE do te ofertohe. Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme për tregtim me shumice të barnave të lëshuar nga QKL ose QKB.

2.3.3. Operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë origjinën e mallit dhe kompaninë prodhuese/MAH, kjo të plotësohet në Shtojcën 2. Listat e Çmimeve të artikujve të DST.

2.3.4. OE duhet të paraqesë:

- dokumenti i cili konfirmon se bari i ofertuar (oksigeni gaz), është i pajisur me autorizim për tregtim në Republikën e Shqipërisë, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore

/ose/

- autorizimi për tregtim i barit (oksigeni gaz), lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, brenda afatit të tij të vlefshmërisë.

2.3.5. Kërkohet Autorizim (i vlefshëm për periudhën e parashikuar të Marrveshjes kuader), lëshuar nga MAH (mbajtësi i autorizimit të tregtimit), nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë barnat e tij në vendin tonë.

2.3.6 OE duhet të disponojë dokumentacion për Automjetet si më poshtë :

Furnizimi të bëhet me me bombola 30 - 40 ose 50 litra me presion deri ne 125 bar dhe Transporti i bombulave të oksigjenit mjekësor i kompresuar, duhet të behet me automjete të pajisura me:

1. Leje për Transport gazra mjekësore nën presion, të lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial.
2. Leje për Transport gazra mjekësore nën presion të lëshuar nga MNZSH.
3. Certifikatë miratimi ADR të lëshuar nga DPSHTRR.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e vetëdeklarimit (sipas shtojcës 8)

2.3.7. Operatori ekonomik duhet të provojë se, nëse shpallet fitues, do të ketë në dispozicion minimumi **50** bombola oksigjeni mjekësor / pako bombola, në pronësi ose me qira. Për të vërtetuar këtë kriter, operatori ekonomik duhet të paraqesë një dëshmi për pasjen në pronësi të kësaj sasive bombolash (fature blerje ose dokument doganor për importimin e bombolave të oksigjenit ose çdo lloj dokumenti tjetër ligjor i cili dëshmon dispononim në pronësi të këtyre bombolave), /ose/ kontrate apo marrëveshje paraprake për marrjen me qira të kësaj sasive bombolash bashkëngjitur dokumentin e pronësisë të qiradhënësit (fature blerje /ose/ dokument doganor për importimin e bombolave të oksigjenit ose çdo lloj dokumenti tjetër ligjor i cili dëshmon dispononim në pronësi të këtyre bombolave.

Shënim: Furnizimi do behet me bombola 30 - 40 ose 50 litra me presion deri ne 125 bar.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST.

2.3.8. Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se bombolat e oksigjenit, që do të furnizohen prej tij, plotësojnë kushtet teknike të pajisjeve nën presion. Për këtë duhet të paraqesë vërtetim të lëshuar të vlefshëm, nga organet kompetente për regjistrimin, kontrollin e kushteve teknike dhe të sigurisë, për enët nën presion tankera/serbatore/cisterna, konform legjislacionit në fuqi, ku të jënë përcaktuar numri dhe kapaciteti i tyre, data e kontrollit, organi inspektues dhe plotësimi i standardeve, kushteve teknike dhe të sigurisë.

Shënim: Oksigjeni i bombolave që do të përdoren duhet të jete i regjistruar në AKBPM për tregtim në Republikën e Shqipërisë

Shënime:

Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, **i ndryshuar**, ku parashikohet : *“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”*, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: ***“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”***.

- Disponimi i kapaciteteve sipas **pikave 8, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit Oxygen i Gaztë dhe Oxygen i Lëngshëm**, do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit (shtojca 8) gjatë fazës së ofertimit.
- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, do t'i kërkojë ofertuesit fitues nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 8 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit përmbushes për këto pika do të jetë kusht skualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor mund të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht skualifikimi.
- Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

CERTIFIKATAT E CILËSISË

